



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

Nr. 95 Prot.

Tiranë, më 08.03.2018

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune

DREJTUAR: AGJENCISË SE PROKURIMIT PUBLIK
Shërbimi Kombëtar i Punësimit

TIRANË

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë" Urdhërin e Kryeministrit Nr. 171 datë 27.09.2010 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Akreditimit të Arsimit të Lartë", dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësimi drejtuese", Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për **1 (nje) vendë të lirë pune në pozicionin e Përgjegjës i Sektorit të Promocionit dhe Vlerësimit të Cilësisë**
Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të me mesatare mbi 8(tetë).
2. Të ketë përvojë pune të paktën 10 vjecare në profesion.
3. Të ketë përvojë pune në arsimin e lartë ose në institucionet që lidhen me arsimin e lartë.
4. Të zotërojë gjuhën angleze me dëshmi.
5. Të ketë njohuri të mira kompjuterike në programet bazë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë.
2. Të ketë njohuri mbi institucionet e arsimit të lartë, procedurat, kriteret dhe aktet nënligjore të sistemit të akreditimit dhe vlerësimit të cilësisë.
3. Preferohen kandidatë që kanë përvojë pune të mëparshme në ASCAL dhe në drejtimin e proveve të vlerësimit dhe akreditimit.
4. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira shkrimi dhe komunikuese.
5. Të dëshmojë aftësi për të punuar në grup.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 30.03.2018, ora 12.00 në adresën e mëposhtme;

Mund të aplikojnë edhe kandidatë që janë pjesë e stafit të ASCAL. Për këta kandidatë kërkohet plotësimi i dokumentacionit sipas pikës III ose përditësimi i atij ekzistuese.

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.
Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit “Qemal Stafa”
Tel: 4 22 43 423**

- Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë;
www.ascal.al

DREJTORI

Dhurata Bozo

